

Metoda mësimdhënieje:

1. *Situatat mësimore*

Përdorimi i situatave mësimore ose siç quhen ndryshe “kazuset” janë një pjesë e rëndësishme e procesit të të mësuarit praktik. Situata mësimore kërkon që nxënësit të analizojnë një situatë konkrete me probleme, të shfaqin opinionet dhe të parashtrajnë zgjidhjet e tyre. Teknika mund të marrë disa forma dhe zakonisht paraqet disa konflikte ose dilema të marra nga jeta reale ose të sajua nga ngjarjet e përshkruara në gazeta, nga ngjarjet e ndodhura në komunitet, nga librat ose burime të tjera.

Një situatë mësimore zakonisht përfshin elementët e mëposhtëm: një përshkrim të faktit (ngjarjes), paraqitjen e çështjes apo të problemit që del nga konflikti, referencën ndaj argumentave për qëndrimet e ndryshme që mund të mbahen ndaj problemit, vendimin apo rezultatet aktuale të marra mbi problemin dhe sqarime rreth nevojës për arsyetim e analizë për rezultatet e arritura. Sqarimet mbi arsyetimet dhe analizat për vendimet dhe rezultatet e arritura mund të jepen, sipas rastit dhe qëllimit që dëshirojmë të arrijmë nga përdorimi i kësaj teknike, gjatë paraqitjes së situatës mësimore ose drejtuesi i orës mësimore mund t’i mbajë pa i treguar për të krahasuar një zgjidhje të suksesëshme me atë që ofrojnë nxënësit gjatë punës së tyre në klasë. Zakonisht, gjatë përgatitjes për zgjidhjen e një situatë mësimore, punohet në grupe.

Qëllimi

“Situata mësimore” është teknikë që bazohet tek dijet dhe njohuritë. Ajo ka si qëllim të ndihmojë nxënësit që të aplikojnë teorinë dhe dijet që kanë mësuar në situata të jetës reale. Me anën e nxitjes për të mos vlerësuar vetëm parimet e aplikuar në njësitat konkrete, por edhe eksplorimin e ideve dhe nxjerrjen e konkluzioneve nga vetë nxënësit. Ky proces ndihmon të rritet interesi dhe të zhvillohen më tej aftësitë e tyre të analizës logjike e të pavarur, të të menduarit kritik dhe të vendimmarrjes.

- a) **Përzgjedhja e materjalit.** Situatat mësimore mund të jenë reale ose imagjinare, të shkurtra ose të gjata; ato duhet të bazohen në ngjarjet aktuale ose në ngjarje të ndodhura në jetën e përditëshme dhe të zgjidhura me sukses nga njerzit e ngarkuar për to. Një situatë mësimore nuk duhet të jetë e ngarkuar me paqartësi të shumta dhe së paku duhet të jetë e qartë për vetë drejtuesin e orës mësimore.
- b) **Shqyrtimi i fakteve.** Evidentimi i fakteve, selseksionimi dhe klasifikimi i tyre sipas rëndësisë dhe ndikimit mbi ngjarjen, ka rëndësi dhe shërben si bazë për diskutimet që do të nxiten në klasë. Kjo do të thotë që procesi i shpalosjes së njohurive dhe dijeve teorike të fillojë me shqyrtimin dhe qartësimin e fakteve dhe efekteve të tyre mbi ngjarjen.
- c) **Evidentimi i çështjeve** ose problemit që paraqitet nga situata. Nxënësit duhet të nxiten të evidentojnë vetë dhe të rendisin çështjet kryesore të problemit që paraqitet në ushtrim. Çdo çështje paraqitet në formën e një pyetje dhe mbi këtë bazë ftohen nxënësit të diskutojnë dhe të shprehin

opinionet e tyre mbi parimet demokratike, ligjet, moralin dhe realitetin konkret.

d) Diskutimi rreth argumentave

- Argumentat pro dhe kundër me çdo zgjidhe të ofruar. Kur vrehet se nxënësit kanë arritur të përndrohen mbi problemin dhe çështjet e tij, ftohen të diskutojnë rreth argumentave që ata japin në favor dhe kundër për çdo këndvështrim që u paraqit më parë. Kjo bëhet duke i pyetur :
- Cilat ishin argumentat pro dhe kundër që u paraqitën për çdo këndvështrim?
- Me cilat jemi personalisht dakord? Që nuk jemi dakord? Pse?
- Pasojat që mund të vijnë nga veprimet që u sugjeruan? Për pjesët? Për tërë shoqërinë?
- A ka alternativa të tjera

Gjatë diskutimit është e rëndësishme të krijohet në klasë një klimë e pranimit dhe e oponencës. Nxënësit duhet të dinë se të gjitha opinionet janë të mirëpritura dhe se idetë e tyre do të vlerësohen njëllë, me kujdes dhe analiza nuk ka të bëjë me faktin se ata mund të mendojnë ndryshe. Me fjalë të tjera nxënësit do të nxiten të dëgjojnë njeri tjetrin dhe punonjësin e policisë dhe të vlerësojnë së bashku të gjitha pikpamjet dhe opinionet që kanë edhe pse mind të jenë të ndryshme dhe ndoshta të kundërta.

- e) Arritja e një konkluzioni dhe një vendimi.** Nxënësit duke të japin një përgjigje për zgjidhjen e situatës ose pjesëve të veçanta të saj. Pastaj nxënësit ftohen ta vlerësojnë së bashku zgjidhjen e bërë në realitet dhe të shprehin opinionin e tyre pse janë apo nuk janë dakord me të. Cila do të ishte domethënia apo efekti i kësaj zgjidhje për grupet e shoqërisë ku bëjmë pjesë? Po për shoqërinë në tërësi? Në disa raste zgjidhja mund të mos tregohet dhe ftohen nxënësit të japin variantet e tyre të zgjidhjes që ofrojnë. Pasi janë dhënë të gjitha zgjidhjet e mundëshme nga nxënësit, drejtuesi i seancës mësimore tregon se cila ka qënë zgjidhja e vërtetë nëse situata ka qënë reale për ta krahasuar. Është e rëndësishme që nxënësve tu qartësohet se zgjidhjet e tyre nuk kanë qënë të “gabuar”, por vetëm se problemi është zgjidhur në një mënyrë tjetër alternative.

Llojet më tipike. Kur përdoret si teknikë mësimdhënie situata mësimore, drejtuesi i seancës mund të dëshirojë të përdorë variacione të kësaj metode. Më tipiket janë:

- U jepet nxënësve një situatë e tërë faktike (faktet, çështjet, problemet, argumentat dhe arsyetimi i bërë). Ky variant i fokuson nxënësit në krahasimin e fakteve, çështjeve që shtrohen e vendimet që janë marrë. Ai ndihmon në përdorimin e vlerësimit e vendimit dhe arsyetimit të përdorur për të.
- U jepen nxënësve variante të ndryshme vendimesh për një situatë konkrete (faktet, çështjet, argumentat dhe arsyetimet e bëra). Gjatë këtij varianti, nxënësit nuk e dinë se cili nga vendimet alternative është përdorur në zgjidhjen e situatës në realitet. Atyre u kërkohet të përzgjedhin vendimin me të cilin janë dakord dhe të shpjegojnë pse. Më vonë atyre mund tu jepet zgjidhja reale dhe tu kërkohet ta krahasojnë me të tyren.
- U jepen nxënësve vetëm faktet. Gjatë përdorimit të këtij varianti, u kërkohet nxënësve të identifikojnë dhe të formulojnë vetë çështjet, të gjejnë vetë argumentat për çdo hap dhe të përpunojnë një plan veprimi. Mbas kësaj faze,

vazhdohet si më sipër me vlerësimin së bashku të çështjeve, argumentave dhe vendimeve.

Shënim: mund të krijohet ideja se teknika ka vlerë vetëm me nxënësit e klasave të larta të shkollës së mesme. Sidoqoftë, nëse merren parasysh që çdo grupmoshë ka problemet e veta me të cilat ndeshet, dhe policia ka probleme me të gjitha grupmoshat shkollore, teknika është e dobishme për të gjithë nëse përdoret me kujdes dhe nëse situatat e përzgjedhura i përkasin grupmoshës.

2. Lozja e roleve

Lozja e roleve është një veprimtari në të cilën nxënësit marrin rolin e dikujt tjetër nga jeta reale dhe e luajnë atë sikur të ishin vetë. Kjo teknikë ngjan mjaft me teatrin.

Në këtë teknikë, nxënësve zakonisht u jepet një situatë në të cilën ata duhet të marrin një vendim, të zgjidhin një konflikt ose të përfundojnë një ngjarje të papërfunduar.

Qëllimi

Në thelb, lozja e roleve si teknikë mësimore është parashikuar dhe përdoret për tu dhënë mundësi nxënësve të kuptojnë dhe të bashkëveprojnë me njeri tjetrin. Duke lozur rolin e dikujt tjetër, është më e lehtë të perceptosh dhe kuptosh këndvështrimet dhe idetë e tyre, duke përfshirë atë se si mendojnë dhe çfarë ndjejnë ata.

- **Përzgjedhja e një situatë** për të organizuar një lozje rolesh. Disa situata japin shumë mundësi në vetvete për të organizuar lozje të roleve; psh dilemat individuale, ose situatat me zgjidhje konfliktesh. (teknikat 1 dhe 2 që kemi rekomanduar në manual bazaohen pikërisht në lozjen e roleve në një situatë me konflikt). Lozja e roleve është gjithashtu e dobishme edhe për të nxitur dhe aftësuar nxënësit si intervistuesë, si negociatorë, gjurmuesë, mediatorë dhe vendimmarrës.
- **Përgatitja e skenarit** dhe mësimi i pjesëve veç e veç nga pjesamrresit. Nxënësve u tregohet një e nga një se çfarë do të bëjnë dhe ç'rol do të lozin, sipas një skice të parapërgatitur që më parë sipas një ngjarje reale. Brenda këtij skenari atyre u jepet hapësirë e mjaftueshme edhe për improvizime dhe kontribut nga ana e tyre.

Nëse lozja e roleve është e re për nxënësit, është e domosdoshme një aktivitet hyrës nga ana e mësuesit për dobinë dhe avantazhet e saj. Nxënësve psh u kërkohet të lozin rolin e dikujt që ka humbur mikun e vet të ngushtë, ose të atij që ka shkelur një rregull dhe e bren ndërjegjia për dëmin që u ka shkaktuar pa dashje miqëve dhe shokëve të tij.

- **Përzgjedhja e pjesmarrësve.** Rolet mund të caktohen nga mësuesi ose të përzgjidhen nga vetë nxënësit mbi baza vullnetare. Në një aktivitet të tillë mund të zhvillohet para gjithë klasës, ose sipas llojit të situatës klasa mund të ndahet në disa grupe më të vogla. Është e rëndësishme që çdo pjesmarrës (aktor) të dijë mirë se çfarë kërkohet prej tij. Në caktimin e roleve nga drejtuesi i orës mësimore është e dobishme të mbahen parasysh tipet e të

mësuarit: *aktivistët* përdoren për të luajtur rolet kryesore, *teoristët* dhe *reflektivët* përdoren për të zhvilluar analizën e lozjes dhe evidentimin e problemeve, *pragmatistët* mund të përdoren për të ndihmuar që aktiviteti të mos dalë jashtë kontrollit ose shfrytëzohen për rolet negative. Nëse disa nuk kanë mundësinë të marrin pjesë në aktivitet, caktohen të lozin rolin e vëzhguesve dhe u kërkohet të vendosin dhe të shprehen nëse do të vepronin në të njëjtën mënyrë me shokët e tyre dhe të japin arsyet për përgjigjet e tyre.

- **Zhvillimi i aktivitetit.** Nxënësit vihen të lozin rolet e tyre ashtu siç mendojnë se do të silleshin kur të ndodheshin në një situatë të ngjashme në jetën reale. Mësuesi apo drejtuesi i mësimit nuk duhet ta ndërpresin lojën përderisa mendojnë se duhet përfshirë në të një element i ri ose një fakt i “porsa zbuluar” ose kur vëjnë se situata mund të dalë nga kontrolli, psh mund të degjenerojë në një konflikt real, mund të devijojë nga qëllimi, ose mund të marrë ngjyra satirike e tallëse. Mbas një lozje rolesh, disa herë është e dobishme që nxënësit të rilozin rolet e tyre ose të riluhet aktiviteti nga pjesmarrës të tjerë.
- **Analiza dhe vlerësimi.** Aktivitetet me lozje rolesh duhet të analizohen dhe të vlerësohen me kujdes. Pa një qëndrim kritik ndaj tyre, si fazë përbërëse efektet nuk do të ishin plotësisht ato që priten. Analiza e roleve të luajtura dhe rezultateve që u arritën nga të gjithë pjesmarrësit dhe vëzhguesit e caktuar, ka vlera të rëndësishme për të nxitur diskutim mbi një teren real dhe të prekshëm, si dhe për të përforcuar aftësitë bashkëbiseduese.

3. **Burimet e komunitetit dhe eksperiencia e nxënësve**

Çdo komunitet ka burime të disponueshëm për të përmirësuar mësimin e demokracisë, të bashkëjetesës dhe të tolerancës së ideve dhe pikpamjeve të ndryshme alternative. Përdorimi i këtyre burimeve në përgjithësi ka dy forma: personat burimorë mund të vijnë në klasë (një person qëka përjetuar një situatë të ngjashme me atë që po diskutohet, një punonjës policie që ka marrë pjesë në ngjarjen që lidhet me temën e mësimit, një prind apo një përfaqësues i komunitetit), ose klasa shkon për vizitë në vendin ku ka ndodhur ngjarja apo ku ndodhen ata që kanë marrë pjesë në të. Sëbashku me këta persona burimorë, në të dyja rastet organizohet një bashkëbisedim.

Qëllimi

Përvoja e nxënësve në terren dhe përdorimi i burimeve të komunitetit mund t’i pajisë ata me informacion, materiale dhe eksperiencia të reja e të ndryshme nga ato që gjejnë nëpër libra; më afër problemeve të tyre dhe më jetësor.

a) Aktivizimi i personave burimorë të përvojave

- **Përzgjedhja e personit burimor** sipas problemit dhe çështjes në bashkëbisedim. Në vartësi të llojit të klasës dhe të qëllimit të mësimit, mund të gjenden një shumëllojshmëri personash burimorë që mund të ftohen në mësime. Ndër më të zakonshmit mund të jenë politikanët, drejtuesit e policisë, liderët e komunitetit, specialistët e policisë, juristë, prindër, këshilltarët e pushtetit vendor, prokurorë, avokatë dhe njerëz që kanë përjetuar ngjarje të rëndësishme në jetën e komunitetit. Drejtuesit lokalë të policisë dhe specialistët e ligjit mund të ftohen të flasin për

aspektet ligjore të parandalimit të krimit dhe metodat e vetparandalimit të viktimizimit etj.

- **Përgatitja e personit për të folur dhe e klasës.** Për të arritur një shfrytëzim sa më të mirë të folësi të jashtëm është e domosdoshme një planifikim paraprak. Pa dyshim që mësuesi apo drejtuesi i seancës duhet të tregojë kujdes për mirëadministrimin e orës mësimore. Është e rëndësishme të mbahet parasysh që folësi dhe klasa duhet të jenë që më parë të përgatitur për pjesmarrjen. I ftuari duhet të dijë qëllimin dhe të njohë që më parë karakteristikat e nxënësve dhe objektivat që synohen. Nga ana tjetër klasa duhet të dijë se si i ftuari do të ndihmojë për të arritur objektivat e mësimi të tyre. Nxënësve u jepen disa njohuri e detyra paraprake për të përgatitur, si dhe u kërkohet të përgatisin lista me pyetje, mundësisht me shkrim, për t'ja drejtuar të ftuarit.
- **Përpunimi i materialit** të ofruar në përputhje me çështjen (udhëheqja e klasës). Zakonisht personave të ftuar bëjnë një prezantim të shkurtër në çështjet ku janë ekspertë apo kanë përjetuar përvoja dhe pastaj zhvillohet një seancë pyetje – përgjigje.

Sidoqë kjo është forma më e mirë në përgjithësi, ka edhe mënyra të tjera mjaft efektive ku personi burimor apo i ftuari përfshihet në një simulim loje apo lozje rolesh, organizimi i një interviste prej tij sikur do të bënin një emision në radio, apo para një kamere, organizimi i një lozje rolesh nga nxënësit në detyrën që ka apo në situatën që ka përjetuar personi burimor dhe në përfundim ai ftohet të bëjë një analizë të shkurtër të mënyrës se si u krye detyra apo u zgjidh situata nga nxënësit.

- **Analiza e mësimi** dhe fidebaku i njohurive. Aq sa është e rëndësishme të përgatiten nxënësit për pjesmarrjen e të ftuarit, po aq është e rëndësishme edhe analiza e përvojave të reja që u përcollën. Nxënësve u kërkohet të japin vlerësimet e tyre për atë që panë, që dëgjuan dhe mësuan në klasë.

b) Vizita në zona të komunitetit dhe në komisariatet e policisë

• **Përcaktimi i qëllimit dhe vendit** të vizitës. Qëllimet për të zhvilluar vizita të tilla mund të përcaktohen në përputhje me nevojat që lindin sipas temave të planifikura të zhvillohen në projekt. Të tilla mund të jenë mjediset e komisariatit të policisë, salla e drejtimit e autoparullave të policisë, postat e policisë, mjediset e shërbimit të policisë, një kryqëzim rruge, një postblok policie etj. Vizitat e zhvilluara me nxënësit e disa shkollave dhe fëmijët e kopështit në Tiranë, të përfshira si modele në manual i përkasin kësaj teknike.

• **Planifikimi i aktiviteteve** që do të zhvillohen. Ashtu sikurse në rastin e teknikës së personin burimor apo e “të ftuarit të posaçëm”, nxënësit duhet të parapërgatiten për vizitën, si dhe duhen bërë përpjekje për të marrë garancitë e duhura që personeli i komisariatit të policisë, i postës së policisë apo i punonjësve të shërbimit që është planifikuar për të vizituar të jenë të disponueshëm dhe të angazhohen plotësisht në aktivitet. Psh nëse do të shkohet për vizitë në një komisariat apo postë policie, mësuesi apo drejtuesi i vizitës duhet të marrë kontakt që më parë me drejtuesit e komisariatit apo postës së policisë për të përcaktuar kohën e ditën më të përshtatëshme dhe personat që do të përfshihen në aktivitet. Një ekspert policie mund të caktohet tu flasë nxënësve për tu shpjeguar qëllimet e vizitës dhe atë se çfarë mund të mësohet prej saj si dhe të përgatisë një fletë vëzhgimi (në të parashtrohen

pyetje si: *Çfarë vutë re? Si dhe çfarë ndjetë ndaj atyre që dëgjuat? Çfarë mësuar nga kjo vizitë – rrendisni disa nga opinionet dhe përvojat që përjetuat si më të dobishme? Çfarë mësuar si gjë të re në krahasim me njohuritë që kini marrë? Çfarë tjetër do të dëshironit të dinit apo ta thellonit më tej?*) në të cilën nxënësit të orientohen për shënimet që do të mbajnë rreth asaj që ju thuhet dhe opinionet e tyre për atë çfarë mësuar të re si njohuri dhe si përvojë.

• **Përgatitja e nxënësve** për të bërë pyetje dhe për të dhënë opinionet e tyre. Sikurse në çdo mësim nxënësit parapërgatiten të bëjnë pyetje, të vëzhgojnë veprime dhe sjellje të veçanta si vepron policia në raste të ngjashme me ato që përfshihen në qëllimin e mësimin dhe të mbajnë shënime mbi reagimet apo opinionet e tyre në fletën boshe të vëzhgimit që do tu jepet. Planifikimi i kujdesshëm paraprak i vizitës është kyç për ta zhvilluar atë me sukses e në mënyrë të dobishme për nxënësit.

• **Analiza** e përfundimeve dhe fdbek për njohuritë e përpunuara. Qoftë kur planifikohet për tu zhvilluar në mjediset e komisariatit apo postës së policisë, qoftë kur planifikohet të zhvillohet në klasë, zhvillimi i analizës së aktivitetit duhet bërë mbi bazën e shënimeve të mbajtura në fletën e vëzhgimit. Mbi bazën e përfundimeve të analizës, mësuesi apo drejtuesi i mësimin plotësojnë e rifreskojnë njohuritë e nxënësve në fund të analizës.

4. **Qartësimi i vlerave**

Demokracia është e bazuar në një shumëllojshmëri vlerash, qëndrimesh dhe idealesh. Këto vlera , qëndrime dhe ideale qëndrojnë në themel të çdo marrëdhënie që krijohet midis policisë dhe publikut, midis komuniteteve të nxënësve dhe sistemit të zbatimit të ligjit, midis individëve dhe shtetit ligjor. Të mësosh ç’është demokracia, të përfshihesh në zbatimin e rregullave dhe ligjeve të saj, të bëhesh i vetdijshëm se parandalimi i krimit është një obligim qytetar i gjithë shoqërisë e jo vetëm i policisë, të ndërgjegjësohesh se rreshtimi përkrah forcave shoqërore që zbatojnë ligjin është e dobishme për të sotmen dhe për të ardhmen e qytetëruar, do të thotë të fitosh dije në respektimin e vlerave që nënvizojnë sistemin shoqëror e ligjor demokratik dhe t’i bësh këto vlera pjesë të besimit personal. Qartësimi i vlerave është një proces që nxit shpalosjen, shpjegimin dhe shqyrtimin e vlerave, qëndrimeve e opinioneve personale duke i shkëmbyer me ato që kanë të tjerët.

Qëllimi

Qartësimi i vlerave është i rëndësishëm për nxitjen tek nxënësit të aftësive të të dëgjuarit dhe komunikimit; të rritjes së shkallës të të kuptuarit dhe të pranuarit të mendimeve, ideve dhe opinioneve që kanë të tjerët, si pika alternative, si mënyra të të menduarit ndryshe dhe jo si opinione kundërshtare, të gabuara apo të papranueshme; të përmirësimit të aftësive për të zgjidhur probleme dhe për të marrë vendime të bazuara tek morali dhe ligji; të zhvillimit të aftësive të të gjykuarit në mënyrë të arsyeshme dhe kritike dhe të përmirësimit të aftësisë të nxënësve për të pasur dhe përdorur besime të qëndrueshme.

Për të zhvilluar një mësimdhënie të tillë, ndiqet kjo radhë pune:

- **Evidentohen vlerat** që lidhen me problemin që trajtohet sipas mësimin. Kjo nënkupton dhënien e mundësisë nxënësve për të identifikuar qëndrimin e tyre individual ndaj një çështje të dhënë. Në mënyrën më të thjeshtë ajo mund të zhvillohet duke ju drejtuar nxënësve pyetjet:

1. Cili është opinioni juaj?
 2. Cilin nga opinionet do të mbanit?
 3. Çfarë ndjeni rreth kësaj çështje?
- **Ftohen nxënësit të shprehin opinionet** e tyre rreth çështjes dhe vlerave. Kjo mund të arrihet duke ju drejtuar nxënësve pyetje si:
 1. A mund ta shpjgoni qëndrimin tuaj?
 2. A mund të jepni një përkufizim ku e bazoni këtë qëndrim?
 - **Shqyrtohen arsyet e opinionëve.** Në këtë fazë mund të drejtohen pyetje si:
 1. Pse e besoni një gjë të tillë?
 2. Cilat do të ishin arsyet apo shkaqet që ju mbani këtë qëndrim?
 3. Pse ndjeni se kjo është mënyra më e mirë dhe e dobishme për ju?
 4. Mbi çfarë argumentash e bazoni opinionin tuaj?
 5. Mbi çfarë të dhënash e faktesh e mbështesni pozicionin dhe qëndrimin tuaj?
 - **Sugjerohet vlerësimi i pikpamjeve të tjerëve si opinione alternative.** Kjo fazë është e rëndësishme dhe kyçe në arritjen e qëllimit të teknikës dhe mund të realizohet duke ju kërkuar nxënësve të bëjnë opozicion me njeri tjetrin ndaj opinionëve dhe pikpamjeve që paraqesin. Kjo mund të kombinohet edhe me teknika të tjera si psh me punën në grupe dyada ose triada ose duke ju kërkuar të shkruajnë opinionet kundërshtuese duke i shkëmbyer me njeri tjetrin ose duke zhvilluar seanca diskutimi për t'i prezantuar para gjithë klasës mbas çdo opinionit.
 - **Analizohen qëndrimet dhe krahasohen opinionet** me njeri tjetrin. Në këtë fazë krahasohen vlerat, që gjatë fazës së mëparëshme u evidentuan si kontrastuese duke zhvilluar diskutim mbi konfliktin që lind midis tyre dhe pasojave të brendëshme që ai ka në besimet e gjithsecilit. Çështjet më tipike që mund të diskutohen mund të formulohen në formën e pyetjeve si:
 1. Cili do të ishte argumenti më i fortë ku e mbështesni pozicionin tuaj?
 2. Cili do të qe argumenti apo pika e dobët e qëndrimit tuaj ndaj çështjes?
 3. Cili mendoni se do të qe argumenti më i fortë i opinionit që është në opozicion me tuajin? Po pika e tij më e dobët?
 4. Çfarë të dhënash apo faktesh mendoni se e kundërshtojnë qëndrimin tuaj?
- Të menduarit në mënyrë kritike mbi pasojat logjike që vijnë nga secili këndvështrim mund të nxitet duke formuluar pyetje të tilla si:
1. Çfarë mund të ndodhë nëse ju përshtasni apo zbatoni në praktikë qëndrimin tuaj?
 2. Sa do të influenconte kjo tek komuniteti tuaj apo më gjerë?
 3. Cili do të qe rezultati përfundimtar i pritëshëm i këtij qëndrimi?
- **Bëhen përpjekje për të marrë një vendim:** “Si do të vepronit nëse do t’ju kërkohej të vepronit për të mbrojtur zbatimin e ligjit?” Kjo do të ishte edhe faza finale, në të cilën nxënësve u kërkohet të marrin një vendim rreth çështjes. Për të arrihur në një finale të tillë atyre u kërkohet të rivlerësojnë dhe të zgjidhin konfliktet që lindën midis këndvështrimeve të ndryshme që u evidentuan në fazat e mësipërme:
 1. Cili do të ishte rezultati më i mirë për të zgjidhur konfliktin që vrehet?
 2. Cili do të qe përfundimi më i dëshirueshëm?
 3. Si do ta zgjidhnit ju?

4. Çfarë mund të bëhet për ta zgjidhur duke ju referuar realitetit dhe mundësive të momentit?
5. Ç'mbetet ende për të bërë që të plotësohen mundësitë e munguara?

5. Teknika për të nxitur aftësitë e të asyetuarit

Ndërmjet më të zakonëshmeve të teknikave që synojnë nxitjen e afësive të të arsyetuarit janë matja dhe votimi i opinionit (anketimi), ushtrimet e renditjes dhe teknikat projektive. Pikat më të rëndësishme të secilës teknikë janë:

- **Matja dhe votimi i opinionëve.** Kjo jep mundësi për t'u shprehur rreth një çështje të caktuar në mënyrë të numurueshme dhe anonime. Zakonisht ajo mat duke votuar një sasi të matëshme opinionesh që fillojnë me opinionin “plotësisht dakord”, “dakord”, “i pavendosur”, “jam kundër”, “jam kategorikisht kundër” të shprehura rreth një problemi, çështje apo zgjidhje të caktuar. Një rezultat i marrë nga kjo matje e votim mund të përdoret si një pikënisje për një diskutim në klasë; i jep mundësi mësuesit apo drejtuesit të mësimit të ketë njohuri rreth vlerave, qëndrimeve dhe besimeve që kanë nxënësit dhe mund të përdoret si një vlerësim për të matur shkallën e ndryshimit që duhet nxitur tek nxënësit në mësimet e tjera më vonë.

Për të zhvilluar një aktivitet të tillë mësuesi apo drejtuesi i mësimit pyet çdo nxënësi për të shprehur privatisht opinionin e tij lidhur me çështjen që diskutohet. Kjo mund të bëhet me anën e një pyetësi të parapërgatitur, në të cilin çdo nxënësi rrethon në anonimatin njerin nga opinionet - “plotësisht dakord”, “dakord”, “i pavendosur”, “jam kundër”, “jam kategorikisht kundër”. Mbasi ta kenë plotësuar të gjithë, mësuesi bën një përmbledhje për të gjithë klasën, psh për çështjen e parë 30% janë shprehur “plotësisht dakord”, 10% “dakord”, 12% janë shprehur “i pavendosur” e kështu me radhë. Në një rast të tillë të dhënat mund të përdoren për të nxitur një diskutim në klasë

Gjithashtu aktiviteti mund të zhvillohet edhe duke i kërkuar opinionet për çështjet e caktuara, duke ngritur thjesht dorën. Psh “sa fort jeni dakord me thënien që është parqitur në fletën që keni përpara. Në këtë rast në vazhdim nxënësve u kërkohet të justifikojnë opinionet e tyre dhe të dëgjojnë mendimet alternative të shokëve të tyre. Mësuesi përdor pyetësorë të ndryshëm për të njëjtën çështje apo parime që të vrejë qëndrueshmërinë e nxënësve në opinionet e tyre dhe mund ta vazhdojë me një situatë mësimore mbi atë temë.

- **Ushtrim: bërje klasifikimesh (renditje).** Edhe kjo teknikë përqëndrohet në analizën dhe diskutimin rreth besimeve të nxënësve mbi çështjet që përmban tema. Ajo jep mundësi të bëhen përzgjedhje midis alternativave konkurruese në zgjidhjen e një problemi sipas një kriteri. Psh nxënësve ju paraqiten disa lloj abuzimesh apo shkeljesh të ligjit apo të normave morale apo të keqsjelljeve karakteristike për grupmoshën apo komunitetin e nxënësve apo shkaqesh që ndikojnë tek qytetarët për të krijuar opinione negative mbi veprimet e policisë. Pastaj u kërkohet t'i rendisin sipas një kriteri, psh nga më e lehta për t'u bërë apo besuar tek më e vështira apo nga më e tolerueshmja tek më e patolerueshmja. Në një nga variacionet e teknikës nxënësve u kërkohet të vendosin veten e tyre në vendin e atyre që i kryejnë veprimet apo qëndrimet e parashtruara duke i renditur rastet sipas ndjenjës

që u krijohet për çdo koncept apo pohim të bërë në listën e dhënë nga mësuesi. Është e rëndësishme që nxënësve t'u jepet mundësia të justifikojnë renditjet që japin, të dëgjojnë mendimet e kundërta që kanë shokët e tyre dhe të rivlerësojnë pozicionin e tyre në raport me diskutimin që zhvillohet.

- **Teknika projektive.** Kjo teknikë lejon që nxënësit të reagojnë lirshëm dhe sipas opinioneve të tyre personale mbi bazën e disa nxitësve (pyetje të hapura dhe të strukturuar). Psh nxënësve u jepen të përgjigjen duke plotësuar disa fjali të papërfunduara si:

- Këshilla ime, që policia e shtetit të gëzojë mirëbesimin dhe që ketë një imazh pozitiv tek qytetarët është ...
- Unë do të dëshiroja që policia të më këshillonte për ...
- Mendoj se ajo që duhet të bëjmë ne së bashku me punonjësit e policisë për të parandaluar prishjet e rendit dhe kundravjatjet apo krimet nëpër shkolla është ...

Po kështu nxënësve mund t'u kërkohet të shkruajnë një diçiturë për një vizatim apo fotografi ose të vazhdojnë me shkrim përfundimin për një ngjarje apo ndodhi të papërfunduar që u jep mësuesi dhe pastaj të dikutojnë rreth gjetjeve të tyre. Kjo mund të bëhet veç e veç nga çdo nxënës ose mund të punohet me grupe, duke organizuar edhe një konkurs për përfundimin më të arritur.

6. Materjalet vizuale

Fotografitë, vizatimet, pikturat, videot dhe pjesët nga filmat artistikë janë burime që mund të përdoren në mënyrë të dobishme për qëllimin që kemi. Ato mund të krijohen vetë nga mësuesi, nga nxënës të talentuar në këtë drejtim me kërkesë të mësuesit, nga tekstet, librat artistikë, nga gazetatat e revistat dhe botime të tjera (psh fletëpalosjet, broshurat, manualët), ndërsa videot dhe pjesët filmike mund të sigurohen nga qendrat e specializuara për prodhimin e tyre (psh nga qendrat televizive, nga sektorët e posaçëm të policisë, nga libraritë, ose mund të prodhohen nga vetë shkollat kur janë mundësitë teknike për t'i përgatitur)

Qëllimi

Fotografitë, vizatimet, pikturat, videot dhe filmat mund të përdoren për të nxitur interesin e nxënësve mbi çështjen që diskutohet, mund t'i ndihmojnë për të rikujtuar eksperiencat e mëparëshme të tyre, mund të ndihmojnë për të përforcuar të mësuarin, mund të pasurojnë më tej dhe të nxitin të lexuarin, zhvillojnë aftësitë vëzhguese dhe të arsyetuarin kritik dhe më së fundi ndihmojnë për të qartësuar vlerat.

Mënyra që vijon sugjerohet nga studimet e sociologjisë së edukimit:

1. **Nxënësit përshkruajnë çfarë shohin.** Nxënësit nisin të përqendrohen në komponentët e materjalit vizual. Kjo bëhet duke ju kërkuar të përshkruajnë çdo gjë që shohin në figurë apo video.

- Çfarë shikoni? ➤ Çfarë simbolesh janë përdorur

2. **Nxënësit analizojnë atë që shikojnë.** Në këtë fazë nxënësit duhet të analizojnë dhe interpretojnë atë që shikojnë.

- Sa elementë të figurës apo videos lidhen me njeri tjetrin?
 - Cila është pika ku është fokusuar më tepër fotografi, piktori apo regjizori për të arritur qëllimin e vet?
 - Cila është domethënia ose tema mbi të cilën është përgatitur materjali?
 - Si do ta interpretoni ju atë që shikoni?
 - Çfarë përfaqëson figura apo njerzit që janë në të?
3. **Nxënësit aplikojnë idetë që paraqiten në materjalin vizual.** Nxënësve u kërkohet të përqëndrohen dhe të përpiqen të aplikojnë idetë që paraqiten në materjalin vizual përmes një pyetësi si më poshtë:
- Çfarë ju kujton kjo pikturë (apo fotografë apo video apo pjesë filmi)?
 - A mund të jepni mendime rreth ngjarjeve apo ndodhjeve të ngjashme?
 - Si mund të aplikohet kjo ide në komitetin tuaj të shkollës (të banimit)?
4. **Nxënësit qartësojnë besimet dhe vlerat.** Nxënësve u jepet mundësia për të shprehur opinionet e tyre për atë që panë. Kjo mund të organizohet duke u parashtruar një listë pyetjesh si:
- Jeni apo jo dakord me këndvështrimin, idetë dhe pikpamjet që ka përdorur autori në materjalin që paraqitëm?
 - Çfarë, nëse ka diçka, duhet bërë rreth problemit që është portretizuar në figurë (video)?
 - Si do ta paraqisnit ju një ide të ngjashme sido që nuk jeni një artist?

7. Puna në grupe

Përdorimi i punës me grupe tek nxënësit është një teknikë mjaft e dobishme dhe frutdhënëse, sepse ajo është një nga mënyrat më të mira për të siguruar pjesëmarrje sa më të madhe të të gjithë klasës në diskutime dhe në debat. Sidoqoftë, puna me grupe është gjithmonë diçka më shumë se sa një diskutim i përgjithshëm. Ajo kërkon që mësuesi apo drejtuesi i orës mësimore të parapërgatitet për ta aplikuar atë, të parapërgasë nxënësit, të mbajë nën kontroll dhe të ndihmojë grupet për të arritur qëllimin e përcaktuar.

Sipas përmasave, puna me grupe zhvillohet në: *Dyada* = me dy antarë, që përpiqen së bashku të arrijnë mirkuptim dhe të ndihmojnë njeri tjetrin të harmonizojnë preferencat; *Triadat* = me tri antarë, që krijojnë lehtësi për të përpunuar ide të reja nga puna e përbashkët; *Grupet e vogla* = me pesë antarë, që përbën përmasëm më ideale të grupeve që kanë një detyrë për të zgjidhur; *Grupet me 6 deri 10 antarë*, kanë përdorim më të kufizuar për sa i përket diskutimit, zgjidhjes së një problemi, por janë të dobishëm për lozje rolesh. Sidoqoftë shtimi i numurit ndikon negativisht në nevojën për bashkëpunim, shpenzon më tepër kohë dhe zvogëlon mundësitë që të gjithë të mundin të kontribuojnë me idetë, opinionet dhe diskutimet e tyre.

Një nga gjërat e rëndësishme të punës në grupe nuk është aq numuri i antarëve të tij, sesa procesi që zhvillohet ndërmjet tyre. Në këtë këndvështrim puna me grupe paraqet disa avantazhe dhe disavantazhe.

Avantazhet:

- Inkurajon veprimin dhe pjesëmarrjen e pjestarëve të grupit;
- Grupet mund të krijojnë mjaft variacione dhe të nxisin idetë më tepër sesa kur individët punojnë të veçuar;
- Antarët e grupit mësojnë nga njeri tjetri dhe nga mësuesi njëkohësisht;

- Nxënësit flasin më lirshëm kur janë në grupe të vogla, ses përballë gjithë klasës;
- Konkurrimi midis grupeve nxit produktivitetin në njësinë e kohës;

Disaavantazhet:

- Dikutimi në grupe konsumon një pjesë të kohës së mësimit;
- Disa nga antarët e grupit mund të dominojnë mbi të tjerët;
- Mund të devijojë ose të humbasë orientimi i diskutimit apo i detyrës së grupit;
- Aspektet sociale të grupit mund të vendosen para qëllimit të mësimit dhe mund të ndodhë ajo që quhet humbje sociale e kohës së punës.

Detyra e mësuesit kur organizon mësimin me grupe pune është të ndjekë një radhë pune, që konsiston në:

Kontrolli

Përcaktimi i detyrave për çdo grup dhe ndjekja në vazhdim dhe nga afër e punës së çdo grupi;

Këshillimi

Dhënie e informacionit sa herë është e nevojshme për nxënësit dhe e sugjerimeve për të përmirësuar rezultatin epunës në grup;

Ndihma

Nxitja e pjesmarrjes në punën me grupe dhe në diskutimet që zhvillohen në to;

Pjesmarrja

Dhënia e kontributit, ideve dhe zgjidhjeve kur është e përshtatshme;

Qëndrimi jashtë grupeve

Lejimi i grupeve që të punojnë në mënyrë të pavarur;

Mbikqyrja

Vëzhgim i vazhdueshëm i punës në grupe dhe përpjekje për t'i mbajtur ato vazhdimisht brenda caqeve të detyrës

Konkluzionet

Mbledhja, mbajtja shënime dhe lidhja e pikave kryesore të diskutimeve dhe punëve që paraqesin grupet dhe përmbledhja e të gjithë punës së klasës

Dhënia e sqarimeve:

Kur punohet me grupe është e rëndësishme që mësuesi ose drejtuesi i orës mësimore të japë për çdo grup instruksione të posaçme, të qarta për t'i kuptuar si dhe të përcaktojë kohën në të cilën çdo grup duhet të përfundojë detyrën. Mund të jetë e dobishme kur detyrat shkruhen në tabelë, ose jepen në një fletë të shkruar për çdo grup. Sqarimet mund të fillojnë si psh. "Klasa do të ndahet në grupe me nga 5 nxënës dhe do të përgatisë një listë të asaj që presim ne si nxënës dhe si banorë të lagjes nga policia dhe punonjësit e saj që shërbejnë pranë nesh. Njeri nga antarët e grupit do të luajë rolin e mbajtësit të shënimeve, ndërsa një tjetër do të raportojë atë që përgatitët së bashku para klasës. Keni 10 minuta kohë për tu përgatitur"

Mbas tetë minutash mësuesi njofton grupet se kanë mbetur edhe dy minuta gjer në përfundim. Nëse shihet se çdo grup punon me efektivitet mund të shtohet edhe pak kohë shtesë. Vendosja e grupeve është e rëndësishme, sepse

këshillohet që antarët e grupeve duhet të vendosen në mënyrë që të shikojnë dhe të dëgjojnë njeri tjetrin.

Tipe të punës me grupe:

1. **Brainstorming (stuhi mendimesh dhe idesh).** Ky tip është i dobishëm kur duam të nxitim krijimtarinë kolektive të klasës. Ai jep mundësi për pjesmarrje të pakushtëzuar dhe të pa kufizuar të të gjithë nxënësve dhe shpesh ndihmon për të gjeneruar ide dhe zgjidhje të reja. Ajo që është më kryesore tek ky tip pune në grup ka të bëjë më tepër me sasinë e ideve dhe jo me cilësinë e tyre. Brainstormingu mund të përdoret me çfardo përmasë grupi, por ajo nuk këshillohet ta kalojë numurin tetë të pjesmarrësve. Dikush nga grupi caktohet të mbajë shënim të gjitha idetë që jepen dhe mund të bëjë sugjerime të reja. Kur koha mbaron, grupeve ju kërkohet t'i rishqyrtojnë idetë që kanë listuar dhe të bien dakord për ato që ndjejnë se janë më të dobishme. Grupet i paraqesin idetë para klasës për t'i krahasuar me grupet e tjera. Ky tip pune me grupe është mjaft efektiv kur përdoret për të hartuar listën e parimeve, të karakteristikave, të tipareve, të shkeljeve më të zakonshme, apo për të përcaktuar prioritetet.
2. **Grupet "Buzz".** Kjo veprimtari është e ngjashme me brainstormingun, me përjashtim të faktit se në këtë rast grupeve ju caktohet një detyrë specifike me objektiva të qarta dhe të paracaktuara për t'i arritur. Puna në këto grupe i jep gjithsecilit rastin të marrë pjesë dhe të kontribuojë me ide të reja. Nxënësit ndahen në grupe me nga 5 ose 7 antarë. Çdo grup cakton një që të mbajë shënime dhe një drejtues grupi. Drejtuesi kujdeset që çdo antar të ketë rastin të flasë dhe të dëgjohet. Shënimet e mbajtura përpunohen në formën e një raporti që paraqitet para klasës në emër të grupit.
3. **Përgjigje në formë rrethi.** Ky tip është një mënyrë më e strukturuar për të garantuar pjesëmarrje dhe bashkëpunim në grup. Nxënësit vihen në formë rrethi me 12 deri 20 antarë. Secili ka radhë të flasë sipas rendit të lëvizjes së akrepave të orës. Vendosen që më parë rregullat: *"çdo nxënës, një përgjigje; askush nuk mund ta lëjë radhën t'i kalojë; askush nuk mund të flasë jashtë radhës; askush nuk duhet të japë përgjigje identike me shokët e tjerë; askush nuk mund të flasë pa mbaruar së foluri shoku i radhës"*. E rëndësishme është të kuptohet se kjo formë duhet përdorur për të nxitur bashkëpunimin dhe pjesmarrjen dhe çështja apo pyetja që bëhet është e njëjtë për të gjithë. Qëllimi është që të ndahen përgjigjet e çdo individi, meqëse tek nxënësit ndodh fenomeni i shkrirjes së përgjigjes me grupin.
4. **Kujtesë e shpejtë.** Ushtrimi i kujtesës së shpejtë ngjan me përgjigjet në formë rrethi, por në këtë rast nxënësit nuk e flasin përgjigjen e tyre. Përgjigja apo pohimi apo përkufizimi që kërkohet shkruhet në mënyrë anonime në një fletë. Mbase mblidhen fletët shpërndahen dhe lexohen në formë rrethi nga nxënësit që shtojnë në përgjigje, komentet dhe opinionet e tyre. Duke përdorur anonimitetin ka mundësi që edhe nxënësit e drojtur apo të pavendosurit të kontribuojnë dhe të marrin pjesë.